Sanksione:

- Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.
- **Struktura e ngarkuar për dhënie leje** për të vendosur tabelë reklamuese është Policia Bashkiake pranë Bashkisë Prrenjas bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.
- **Struktura e ngarkuar për vjeljen** e kësaj takse është Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.
- **Struktura e ngarkuar për penalitetet** për mos pajisje me leje për vendosje tabele reklamuese është Policia Bashkiake.
- **Afati i njoftimit tatimpaguesve** do të jetë brenda datës 30.04.2026

ANKIMIMET

Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vlerësuar detyrimet e tij, si dhe të apelojë kundër cdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat e Drejtorive përkatëse pranë Bashkisë Prrenjas .

- Çdo tatimpagues që e sheh të padrejtë vlerësimin e detyrimit tatimor apo gjobat e vendosura nga Sektori i Tatim-Taksave të Bashkisë, ka të drejtë të ankohet tek komisioni i apelimit tatimore të emëruar nga kryetari i bashkisë.
- Ankimi paraqitet me shkrim brenda **30 ditëve** nga marrja dijeni për aktin administrativ, dhe përmban:
    a) Emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit;
    b) Vitin tatimor me të cilin lidhet apelimi;
    c) Natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
    d) Baza ku mbështetet apelimi;

- Përgjigjia e ankesës do të merret me shkrim nëpërmjet postës, sipas vendimit të dalë nga komisioni i apelimit tatimor, mbështetur në rregulloren e apelimit tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- Një kopje të vendimit, komisioni i apelimit tatimor e dërgon në Sektorin e Tatim Taksave